



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:186860

Datë: 10.03.2022

Numri i dokumentit: 02796717

**PKR.nr.296/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda**, në përbërje të trupit gjykues nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryetare e trupit gjykues, Sami Sharraxhiu dhe Shaqë Curri anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, si procesmbajtëses, në lëndën penale ndaj të akuzuarit V.B nga fshati K, Komuna P, për shkak se kishte për të kryer vepër penale “Falsifikimi i rezultateve të votimit” nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të rënda, PP/I.nr.202/20 të datës 29.12.2020, pas mbajtje së shqyrtimit gjyqësor në prani të Prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit V.B, me datë 11.02.2022 mori dhe shpalli si dhe me datë 10.03.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**V.B**, i lindur me datë ..... në fshatin K, Komuna P, ku edhe jeton, i biri i M dhe i nënës N e gjinisë G, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me numër personal ....., me numër të telefonit ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së,

**LIROHET NGA AKTAKUZA**

**Për shkak se:**

Me datë 11.06.2017, në fshatin K pikërisht te shkolla fillore “ ..... “ K- P, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e tij lidhur me zgjedhjet ka regjistruar në mënyrë të pa saktë rezultatet e zgjedhjeve ne dokumentet zgjedhore ne atë mënyrë që i pandehuri i cili ishte i autorizuar nga KQZ-ja si kryetar i Komisionit zgjedhore ka shkelur nenin 102 par.2 të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në R. e Kosovës, me çrast ditën kritike në vendvotimin me nr. ...., që ishte në shkollën fillore “..... “ me fshatin K pas rinumërimit të votave me datë 20.09.2021 në Gjykatën Themelore në Pejë, në formularin e

rezultateve të kandidateve janë regjistruar jo saktë 76 vota e kandidateve duke i dëmtuar kandidatet e ndryshëm brenda subjekteve politike PAN, LDK, dhe LVV.

- me çka kishte për të kryer veprë penale “Falsifikimi i rezultateve të votimit” nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së, (nr.04/L-082).

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të rënda, ka ngritë aktakuzë PP/L.nr.202/20 të datës 29.12.2020 ndaj të pandehurit V.B nga fshati K, Komuna P, për veprë penale “Falsifikimi i rezultateve të votimit” nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së.

Gjykata ka mbajte seancën e shqyrtimit gjyqësor ku i akuzuari është njoftuar për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës. P pastaj gjykata ka vazhduar me procedurën e provave.

### *Provat e administruara*

Në procedurën e provave është dëgjuar fillimisht fjala hyrëse më pas janë administruar këto prova:

- në seancë të dt. dëshmitarit A.L, L.T, M.B, I.B të dhëna si në procesverbalin e datës 28.10.2021.
- libri i me shënime rreth procesit të votimit.
- formulari i përputhjes së rezultateve të FPR për vend votimin ... dhe F... të rinumëruara nga QNR.
- tabelave në excell të kandidatit të subjektit politik dhe rezultati pas rinumërimit në QNR,
- procesverbali i datës 20.09.2021 ku është bërë rinumërimi i votave para Gjykate.
- formulari i rinumërimit të bërë në Gjykatë FPR (formulari i përputhjes së rezultateve) dhe FRK
- Formulari i rezultatit të kandidatëve me datë 20.09.2021.
- deklarata e të akuzuarit e dhënë në polici me datë 20.11.2020 dhe në prokurori me datë 28.12.2020.
- formularët e rinumërimit votave në gjykatë.
- flikat e normimit të votave të kandidatëve në vendvotim.

### *Deklaratat e dëshmitarëve*

Dëshmitari A.L në seancën e datës 28.10.2021 ka deklaruar se ditën kritike nuk ka vërejtur ndonjë pa rregullsi ka qenë komisioner nga Lëvizja Vetëvendosje dhe e ka pasur rolin e kontrollorit të gishtit dhe në momentin e numërimit të votave ka bërë ndarjen e fletë votimeve të vlefshme dhe të pa vlefshme, pastaj kanë bërë ndarjen e votave për secilën parti veç e veç dhe pastaj kanë bërë numërimin dhe ka qenë lexues. Kanë qenë katër komisioner, A,L, M dhe I dhe kryesuesi V B. L ka qenë shkrues dhe supozon se ka mundësi të ketë qenë edhe Islami shkues, numërimi i votave dhe shënimi i rezultateve ka qenë 100% i saktë. Ka qenë në qendrën e Votimit nr.... R dhe kanë pasur trajnime të cilat kanë zgjatur dy ditë, kanë qenë shkrues së bashku me L T, kanë qenë dy shkrues dhe dy lexues dhe të dhënat e shkruesve dhe lexuesve janë përputhur, ka qenë vetëm një rast kur nuk janë përputhur votat e partive për dy dhe kanë bërë përsëri numërimin e jo për kandidat. Së pari për secilën parti kemi vendosur në një pozicion të veçantë, pastaj kur kanë bërë

numërimin e secilës parti veç e veç e kanë marrë fletëvotimin e secilës parti veç e veç i kemi vendosur kah 25 copa në një tube, duke bërë veçimin në bazë të pozicionit pasi që kështu parashihet edhe me rregulloren e KQZ-së.

Dëshmitari deklaroi se në ora 19:00 është mbyll vendvotimi dhe para se me filluar gjithçka, si komisioneri dhe kryesuesi në veçanti i ka organizuar në atë formë të gjitha personat si e parasheh ligji i KQZ-së me qenë në klasë, të gjithë janë futur në klasë dhe dera është mbyllur dhe nga ai moment nuk ka lëvizur askush nga klasa. Kryekomisioneri ka mundur me i vëzhgu veprimet e secilit nga ne, është befasuar kur kanë dal 108 vota të regjistruara, nuk ka pasur asnjë problem gjatë leximit dhe gjithçka është shkruar në rregull. Formularin e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve ka qenë në tavolinë të kryekomisionerit këtu V.B e ka plotësuar votat e kandidatëve janë numëruar vetëm një herë, ndërkaq për parti kanë numëruar dy herë, dhe ka pasur përputhje të rezultateve të dy shkruesve kutia është mbyllur në rregull dhe janë vendosuri të gjitha materialet dhe mjetet siç parashihet me rregulloren e KQZ-së.

Dëshmitari *L.T* në seancën e datës 28.10.2021 ka deklaruar se është caktuar si komisioner nga Lëvizja Vetëvendosje në vend votimin në fshatin K për arsye se i kanë besuar se nuk do të lejon keqpërdorime të votës. Gjithçka ka shkruar në rregull, detyra e tij ka qenë verifikimi me lamp para numërimit të votave. Gjatë numërimit të votave nuk i kujtohet detyra sakte, sepse ka mundësi që gjatë numërimit të votave të partisë ka lexuar gjatë numërimit të votave të kandidatëve ndoshta edhe i ka shkruar por nuk i kujtohet sakte gjatë numërimit se çka ka ndodhur. Kanë qenë disa stika që është shënuar emri i partisë dhe në të janë vendosur pastaj votat e partive do të thotë janë ndarë votat.

Fillimisht janë numëruar sa ju takojnë partive, pastaj ka filluar numri i kandidatëve brenda partive. Nuk i kujtohet kush i ka shkruar apo kush i ka lexuar, por e din se kanë qenë dy me i lexu dhe dy me i shkru. Kanë pasur një trajnim të veçan që ka zgjatur një ditë dhe konsideron se i ka kuptuar detyrat dhe rolin e tij edhe përgjegjësit. Të njëjtit i kujtohet saktësisht se numërimi ka shkruar në atë mënyrë që pasi janë ndarë votat e partive, një lexues i ka diktuar një shkruesi për votat e një partie dhe lexuesi tjetër i ka diktuar shkruesit tjetër për votat e partisë tjetër. Në pyetjen sa e ka pasur mundësi me u shenu në mënyrë të pa sakte 108 vota? Dëshmitari ka deklaruar se çështja e numërimit ka qenë në rregull, dhe prej rastit të mëhershëm të kryesuesit ata nuk kanë qenë në gjendje të kuptojnë plotësimin e formularëve, por në rastin konkret nuk ka mundur me e përcjell plotësimin e formularit për shkak se kanë qenë duke numëruar dhe secili ka qenë me detyra. Të dhënat në formular shënohen në disa vende dhe gjatë llogaritjes së votave mund të ndodhin gabime, konsideron se këtu është problem te KQZ-ja dhe organizimi i trajnimeve, meqenëse kryesuesit kanë një trajnim të veçantë dhe ligjëruesi që ju ligjëron nuk e provon se nëse e kanë kuptuar plotësimin e formularit, ndërkaq anëtarët e komisionit nuk e kanë obligim me e plotësu formularin për këtë arsye edhe ndahen trajnimet. Të gjithë janë pajtuar me të dhënat dhe e kanë nënshkruar formularin.

Dëshmitari *M.B* në seancën e datës 28.10.2021 ka deklaruar se gjithçka ka shkruar me rregull, kryesues ka qenë V.B, ky ka qenë komisioner për dhënien e fletëvotimeve nga partia LDK, mbasi janë kryer votimet i ka sistemuar kryesuesi, i njëjti ka thënë me mbyll derën, kështu që i kanë afuar tavolinat, e kanë mbyll derën, dhe gjithçka ka shkruar siç e parashohin rregullat e KQZ-së, i kanë hequr shiritat, i kanë zbrazur votat, i kanë numëruar kah 25,26, kryesuesi i ka plotësuar formularët, kryekomisioneri i ka përcaktuar dy lexues, dhe dy shkrues, Lexuesi i parë i ka bërë dhe janë verifikuar prej dy anëve, një lexon dhe një shkruan, dhe këta dy tjerë e verifikojnë prej dy palëve dhe shikohet a po përputhen prej dy palëve, Dëshmitari deklaroi se sipas librit ne të gjithë

jemi nënshkruar se ato janë shkruar në rregull, dhe në libër nuk janë përputhur dhe sa i kujtohet kanë hy për së dyti dhe i kanë numëruar kandidatët.

Dëshmitari I.B në seancën e datës 28.10.2021 ka deklaruar se në vendvotimin në fshatin K ...R, ka marrë pjesë si komisioner nga P..D.. e K..., sipas tij gjatë gjithë ditës ka shkruar çdo gjë në rregull, ka qenë komisioner për verifikimin e votuesve në libër, vendvotimi është mbyllur me kohë, si komisioner i kanë numëruar votat dhe të njëjtat ia kanë prezantuar kryesuesit, unë kam lexuar, ndërsa ka shkruar A.L, vetëm një ka shkruar, të tjerët kemi diktuar, na si komisioner i ndajmë votat i numërojmë votat e partive, nuk e din se sa persona kanë shkruar dhe prej vitit 2017 nuk ka marr pjesë në zgjedhje, na kur i kemi lexuar janë përputhur të dhënat, aty ka shkruar secila parti për veti, është mbyllur kutia dhe materialet e nevojshme janë mbyllur ashtu siç parashihet.

#### *Mbrojtja e të akuzuarit*

I akuzuari V.B në mbrojtjen e tij ka deklaruar se që nga viti 2008 ka marrë pjesë në zgjedhje, çdo herë ka qenë kryesues, ditën kritike anëtarë i komisionit ka A.L nga partia e Vetëvendosjes, dhe e ka mbrojtur votën e partisë së vetë A i ka ka shti me bo numërimin për tri vota. I .B ka qenë nga subjekt politik PDK dhe ai e ka mbrojtë votën e asaj partie, ndërsa L T është hera e dytë që e ka parë në Gjykatë. Betohet se nuk ka bërë asnjë shkelje ky ka qenë kryesues, I. B dhe A. L kanë qenë shkrues, ndërsa lexues kanë qenë M.B dhe L.T, por ndërkohë janë ndërruar sepse shumë vota është dashur me u numëruar, ndërkaq i pandehuri ka qenë nga AAK-ja, është nënshkruar në formular pasi që janë nënshkruar të gjithë anëtarët dhe i ka pyetur se a është gjithçka në rregull dhe ata i kanë thënë se po. Formularët i ka plotësuar A, ndërkaq për obligim e ka pasur Kryesuesi apo komisioneri dhe plotësimin e ka bërë A, pasi që nuk ka parë mirë për shkak të dritës së dobët, I njëjti deklaroi se i ka njoftuar anëtarët e këshillave se nuk sheh mirë, mirëpo në librin e tij nuk e ka konstatuar si vërejte. I njëjti ka deklaruar se për tri vota e kanë kthyer procesin dhe se formularin e përputhjes së të dhënave dhe rezultatet përfundimtare e ka nënshkruar, pasi që është bërë rinumërimi nga QNR nuk ka qenë i njoftuar për kohën dhe vendin e rinumërimit.

I akuzuari ka dhënë deklaratë në prokurori me dt.29.12.2020 ku ka mohuar fajësinë dhe ka deklaruar në mënyrë po thuajse të ngjashme me atë që ka deklaruar para gjykatës.

#### *Fjala përfundimtare*

Prokurorja e shtetit Valbona Disha Haxhosaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: në çështjen penal ndaj të pandehurit V.B i akuzuar për veprë penale falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par. 1 të KPRK-së, pas administrimit të provave materiale dhe atyre personale është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari V.B ka kryer veprën penale të përshkruar si më poshtë.

Me datë 11.06.2017, në fshatin K pikërisht te shkolla fillore “ ..... “ K- Pejë, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e tij lidhur me zgjedhjet ka regjistruar në mënyrë të pa saktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore në atë mënyrë që i pandehuri i cili ishte i autorizuar nga KQZ-ja si kryetar i Komisionit zgjedhore ka shkelur nenin 102 paragraf 2 të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në R. e Kosovës, me qrast ditën kritike në vendvotimin me nr. ..., që ishte në shkollën fillore “..... “ me fshatin K, pas rinumërimit të votave me datë 20.09.2021 në Gjykatën Themelore në Pejë, në formularin e

rezultateve të kandidateve janë regjistruar jo saktë 76 vota të kandidateve duke i dëmtuar kandidatet e ndryshëm brenda subjekteve politike PAN, LDK, dhe LVV.

-Me çka ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehurit ka kryer veprën penale falsifikimi i rezultati i votimit nga neni 219 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Këtë gjendje faktike të cekur si në dispozitiv është vërtetuar edhe nga dëshmia e vet të pandehurit të dhëne në gjykatë i cili ka deklaruar se sikurse një votë të mos përputhej në mes të FRP dhe FRK-së, i tërë procesi ka filluar me rinumërim të ri. Kjo mbrojtje e tij si për prokurorin por besoi edhe për Gjykatën është orientuar vetëm me ikjen nga përgjegjësia penale sepse këtu janë regjistruar 76 vota në mënyrë të pa saktë. Dhe përse kryesuesi dhe anëtarët e tjerë e në veçanti kryesuesi i cili ka pasur obligim ligjore nuk i kanë eliminuar me kohë shkeljet.

Sigurisht që i akuzuari do të thotë që edhe me rinumërimin në gjykatë nuk janë përputhur të dhënat nga rinumërimin nga KQZ-ja duke u thirrur ne atë se edhe KQZ-ja ka bërë gabime. Mirëpo marrë parasysh se obligimi ligjor dhe në asnjë mënyre nuk janë përputhur të dhënat konsideroi se edhe këtë do të shfrytëzoi në kuptim të mbrojtjes së tij.

Paramendoni vetëm në një klasë të keqpërdoren 76 vota, atëherë veni parasysh në një qendër të votimit sa vota të ketë qenë të keqpërdoruar në favor të kandidateve të caktuar të partive politike. Andaj mbetet pranë aktakuzës të përmirësuar pikërisht dispozitivit të aktakuzës i propozon gjykatës që të pandehurit ta shpallë fajtor ta dënoi sipas ligjit si dhe të obligoi në shpenzimet e procedurës penale. Sa i përket propozimit nga neni 65 të ish KPRK-se, heki dore meqenëse i akuzuari është i pa pune, dhe merret me bujqësi.

I akuzuari *V.B në fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar se; nuk e dije se ku po bazohet prokurorja, ngase ne nuk kemi bërë qëllimisht mund të këtë qenë ndonjë gabim teknik, ka thënë edhe ne fillim kur e ka dhënë deklaratën e parë, nëse del dikush që deklaroi se V ka bërë këtë është i gatshme 10 vite të shkon në burg. Ka thënë edhe në fillim se është i pa fajshëm. Me qellim nuk ka bërë diçka që as unë e askush nga ne.

\* \* \*

Gjykata ka vlerësuar provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe ka gjet se në veprimet e të akuzuarit V.B nuk janë plotësuar elementet e veprës penale që i vihet në barrë.

### *Gjendja e fakteve*

Gjatë shqyrtimit u konstatua se:

-I akuzuari V.B me dt. 11.06.2017, në fshatin K në shkollën fillore “ ..... “ K- P ishte kryetar i komisionit në qendrën vendvotimin me nr. ..., i autorizuar nga KQZ-ja, ndërkaq ishte i caktuar –deleguar nga partia AAK.

-Anëtarë t komisionit të autorizuar nga KQZ ishin dëshmitarët e dëgjuar A.L, L.T të caktuar-deleguar nga partia V, M.B i caktuar-deleguar nga LDK, I.B i caktuar- deleguar nga PDK.

-Të njëjtit ditën kritike pas përfundimit të votimit kishin numëruar votat, ku dhe asnjëri nga anëtarët e komisionit nuk kishin bërë vërejtje për pa rregullsi.

-Ditën kritike dy anëtarë nga komisioni kanë qenë shkruar dhe dy lexues, ku dhe gjatë numërimit i kishin ndërruar rolet për shkak të lodhjes.

-Pas përfundimit të numërimit ishte plotësuar formulari i Përputhjes së të dhënave dhe rezultateve (FPR) dhe formularit i rezultateve të kandidatëve.

-Në qendrën e rinumërimit në KQZ ishte bërë rinumërimi i votave për partitë dhe kandidatet dhe atë nga Kryesuesi S.P, anëtarët F.B, S.GJ, M.M, A.D dhe S.H, ku dhe janë plotësuar formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve dhe formulari i rezultateve të kandidatëve nga ku rezulton se ka mos përputhje të rezultateve për 106 vota me numërimin në vendvotim të cekur më lartë.

#### *Faktet e kontestuara*

Nga ana e të akuzuari V.B u kontestua vetëm faktet që kanë të bëjnë me mospërputhjen e rezultateve dhe qëllimin apo dashjen e tij për të regjistruar votat në mënyrë të pa saktë.

Pikërisht këto fakte të kontestuara e kanë bërë aktakuzën e prokurorisë të pa bazuar.

#### *Vlerësimi i provave*

Nga dëgjimi i dëshmitarëve të cekur si më lartë gjykata ka gjetur se dëshmitarët e dëgjuar ishin pjesë e komisionit ditën kritike kur është bërë numërimi i votave dhe secili nga ta ishte përfaqësues i ndonjë partie politike. Asnjëri nga ta nuk e kontestojnë ndonjë parregullsi të procesit të votimit dhe të gjithë e kishin nënshkruar formularin përfundimtar për rezultatet e votimit.

Dëshmitarët në fjalë e përshkruajnë se si ka shkuar procesi i votimit duke përshkruar se gjatë numërimit kanë qenë në role të ndryshme, duke përcaktuar secili nga ta ka qenë pjesë e numërimit të votave dhe se gjatë procesit të numërimit ka pas ndërrim të rolit të tyre për shkak të punës së lodhshme gjatë procesit.

Dëshmitarët kanë disa kundërthënia sa detyrave që i kishin të përcaktuara ditën kritike, por të gjithë deklaruan se nuk ka pas ndonjë problem apo parregullsi gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave dhe se të gjithë janë pajtuar me rezultatin dhe kanë nënshkruar formularin ua fali besimin dhe nga deklarimi i tyre vërtetohet se nuk ka pasur qëllimit as tendencë nga i akuzuarit si kryesues i komisionit për të falsifikuar apo për të mos shënuar në mënyrë të saktë rezultatet e votimit.

Lidhur me kundërshtimet e cekura si më lartë të dëshmitarëve sa detyrave të tyre gjatë procesit të numërimit në vendvotim gjykata e vlerësoj, por megjë ka kaluar një kohë e gjatë të njëjtëve mund të mos ju kujtohet. Ndërkaq nga flikat ku janë shënuar rezultatet e votimit rrjedh se A.L dhe I.B kanë qenë shkruar dhe janë nënshkruar në fund të flikave që gjykata i kishte në dispozicion.

Nga libri i me shënime rreth procesit të votimit, rrjedhë se nuk është konstatuar ndonjë vërejtje apo parregullsi gjatë votimit apo me procesin e numërimit

Nga flikat e numërimit të votave për kandidatët, formulari i përputhjes së rezultateve të FPR për vend votimin ... dhe ... të të numëruara dhe të rinumëruara nga QNR, tabelave në exel të kandidatëve të subjekteve politike procesverbali i datës 20.09.2021 ku është bërë rinumërimi i votave para Gjykate, si dhe formulari i rinumërimit të bërë në Gjykatë FPR (formulari i përputhjes së rezultateve) dhe FRK Formulari i rezultatit të kandidatëve me datë 20.09.2021. vërtetohet se ka mos përputhje të rezultateve dhe atë, në mesë votave të numëruara të cekura në flika, në formularët e përputhjes së të dhënave dhe formularët e rezultateve të kandidatëve të plotësuar në vendvotim, pastaj ka mospërputhje të rezultateve të kandidatëve në mesë të atyre të numëruara në qendrën të votimit dhe atyre të numëruara në qendër të rinumërimit ku dallimi është për të gjitha subjektet politike 108 vota. Po ashtu edhe më rastin e ri numërimit të rezultateve në gjykatë ka dallim dhe atë në raport me rezultatet e kandidatëve në numëruara qendrën e vendvotimit, ku tani vota të shënuara në mënyrë të pasaktë janë vetëm 76 (për dallim në rinumërimit e bërë në qendër të rinumërimit që ishin 108).

Pra, pas procesit të votimit në gjykatë nga zyrtarët e KQZ-së, Xh.G, D. M, A. R, H. K dhe A.H, pas hapjes së kutisë së votimit dhe numërimit të serishëm të votave gjykata ka konstatuar se rezultati i numërimit të votave ka pas ndryshim nga rezultati i rinumërimit të votave në KQZ dhe si pasoj e kësaj prokuroria ka bërë edhe ndryshimin e aktakuzës duke bërë një përshkrim tjetër të gjendjes faktike ku tani nga prokuroria pretendohet se i akuzuari ka falsifikuar 76 vota do të thotë 32 vota më pak se aktakuza e ngritur fillimisht ( për 108 vota akuzohej fillimisht). Si do të dilte rezultati i votave me një numërim të ri?

Pas numërimit të votave në gjykatë meqenëse ishte e nevojshme të shikoheshin flikat (listat ku është bërë shënimi i votave për kandidatët) gjykata sërish ka kërkuar nga KQZ që të sigurojnë të njëjtat, për të konstatuar nëse rezultati në formularin përfundimtar të rezultateve është bartur bazuar në flikat, ku sërish është sjell në gjykatë kutia e votimit dhe pas verifikimit gjykata ka konstatuar se rezultati që rrjedh nga flikat që gjendeshin në kuti nuk është ai që është bartur në listat përfundimtare e po ashtu nuk përputhej as me rezultatit e Rinumimit në KQZ dhe as me rezultatet e numërimit në gjykatë.

Duke pas parasysh se i akuzuari deklaroj se është bërë numërimi dy herë në vendvotim por që gjykata nuk i kishte në dispozicion flikat në fjalë. Atëherë shtrohet pyetja se ku gjinden flikat në bazë të të cilave është plotësuar formulari e përputhjes ë ? Pasi që rezultatet që janë shënuar në rezultatet e kandidatëve në vendvotim janë më të përafërta me rezultatet që gjendeshin në fikat e numërimit të rezultateve të kandidatëve e po ashtu edhe me numërimin në gjykatë.

Nga të gjitha këto për gjykatën e pa vërtetuar se kush, kur dhe sa vota janë shënuar në mënyrë të pa saktë.? Pasi në të gjitha rezultatet e numërimit ka dallime dhe edhe më rastin e numërimit në gjykatë, gjykata nuk është bindur se rezultati i votave të numëruara në gjykatë të jetë më i saktë, duke parë procesin dhe vështirësitë e paraqitura gjatë rinumërimit.

### *Vlerësimi ligjor*

Gjykata ka vlerësuar provat e lartcekura në raport me elementet e veprës penale “ *falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së*”, dhe ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar se në veprimet e të akuzuarit janë vërtetuar elementet e veprës penale në fjalë, pasi që kishte pa qartësi lidhur

me rezultatet e votimit dhe nuk u provua se i njëjti me veprimet e tij ditën kritike ti ketë vendosur qëllimisht të pa sakta rezultatet apo keqpërdorur autorizimet e ti siç parasheh dispozita ligjore në fjalë. Andaj gjykata të gjitha paqartësitë është dashur që të interpretohen në favor të akuzuarit. Andaj marrë parasysh të gjitha këto, ka ardhë në përfundim dhe ka vendosur që i akuzuari V.B duhet të lirohet nga aktakuza.

*Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale.*

Konform nenit 454 të KPRK-së gjykata u vendos lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2020:186860, 10.03.2022**

**Kryetarja e trupit gjykues**

---

Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.